



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË KORÇE

Vendim

Nr. 36, datë 18 / 04 2012

“Për kalim në privatizim të banesave shtetërore”.

Keshilli i Bashkisë i Qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Ndermarrja e Sherbimeve Publike, “Për kalim në privatizim”, mbështetur në Ligjin Nr. 9232 dt. 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane” i ndryshuar me ligjin nr. 9719 dt. 23.04.2007, VKM nr. 97 dt. 11.09.2000 “Për procedurën e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652 dt. 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore dhe ligjit nr. 9321 dt. 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fonde të shoqërive dhe ndermarrjeve shtetërore”, neni 32 pika e e ligjit 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin, dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar, VKB Nr. 97 datë 11.09.2000, mbështetur në kompetencat që ka dhe pas konsultimeve të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Të kalojë në privatizim banesa e ndodhur në rrugën “Partizani”, pallati 13, kati i dytë i përbërë prej 1 dhomë me sipërfaqe 17.89 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 6.55 m² në të cilën banon familja e Vjollca Numanit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndermarrja e Sherbimeve Publike
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Ilirjan RENDAVINJI